

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Faza e Zhvillimit
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jo e zbatueshme
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	16.10.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	23.10.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	JO.
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MIE- Nr. 9
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Enea Karakaçi enea.karakaci@infrastruktura.gov.al Albiona Korita Albiona.korita@infrastruktura.gov.al Anisa Gjonedaj anisa.gjonedaj@infrastruktura.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (Maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT <i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?</i> Problemi në shqyrtim lidhet me vështirësitë e hasura gjatë zbatimit në praktikë të Ligjit në fuqi nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar”. Gjatë zbatimit të këtij ligji është evidentuar nevoja për të saktësuar aspekte procedurale në fushën e shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, me qëllim trajtimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër. Konkretisht konstatohen: <ol style="list-style-type: none">1.Procedura të zgjatura, të cilat sjellin vonesa dhe bllokim të zbatimit të projekteve dhe investimit.2.Mungesë të planifikimit paraprak të shpronësimeve.3.Borxh i akumuluar për shkak të vonesave në pagesa të subjekteve të shpronësuara.4.Mungesa e negociatave bilaterale me subjektin që do të shpronësohet.5.Procese të shumta gjyqësore me subjektet që do të shpronësohen (shkak masa e vlerës së shpronësimit).	

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat e synuara të propozimit janë si më poshtë:

- Parashikimi për krijimin i e Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, si institucioni përgjegjës për procedurat e shpronësimit, të cilit do t'i kalojnë kompetencat e shpronësimit.
- Saktësimi i procedurave për shpronësim.
- Të gjitha propozimet për miratimin e kërkesave për shpronësim do të iniciohen nga ministri përgjegjës për zhvillimin urban.
- Shqyrtimi i kërkesave për shpronësim në një kohë më të shkurtër.
- Realizimi i procedurave të shpronësimit në mënyrë më efikente duke i përqendruar në një institucion të vetëm, i cili do të realizojë funksionet vetëm lidhur me proceset e shpronësimit.
- Garantimi në shkallë më të lartë i të drejtave të personave që shpronësohen.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikës:

“Opsioni 0” – Ruajtja e “status quo-së”, ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.

“Opsioni 1” – Miratimi i një ligji të ri.

“Opsioni 2” – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet e opsionit të preferuar janë si vijon:

- Ndikimi ekonomik – Ndryshimet e propozuara me anë të kësaj politike nuk kanë ndikim në vlerë monetare.
- Ndikimi cilësor – Ndryshimet në politikën e propozuar, që konsistojnë në rregullimin e procedurave të shpronësimit, do të ndikojnë në:
 - a) Parashikimi për krijimin e një agjencie të re shtetërore përgjegjëse për procedurat e shpronësimit;
 - b) kalimin e kompetencave për procedurat e shpronësimit nga ministritë kompetente tek Agjencia Shtetërore për Shpronësim;

c) saktësimin e procedurave për shpronësim.

- Ndikim mjedisor – Nuk ka ndikim mjedisor.
- Ndikim social – Ndryshimet e propozuara do të ndikojnë në forcimin dhe garantimin e të drejtave themelore të personave që do të preken nga një procedurë shpronësimi.

Ky ligj do të ketë ndikime të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta tek personat që do të shpronësohen, si dhe te subjektet e interesuara për realizimin e një procedure shpronësimi. Pra, ndryshimet e propozuara nuk kanë ndikim në buxhetin e shtetit, por janë të karakterit procedural dhe konkretisht saktësojnë procedurat e shpronësimit.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Rregullimi i aspekteve procedurale përsa i përket shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, mund të realizohet nëpërmjet miratimit të disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues përkatës.

Si e tillë, Opsioni 2 për ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, është opsioni i preferuar.

Ndryshimet e propozuara me anë të këtij Opsioni nuk kanë ndikim në vlerë monetare, por ndikojnë në lehtësimin e procedurave të shpronësimit. Pra, ndryshimet janë të aspektit procedural.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
Jo e zbatueshme	Jo e zbatueshme	Jo e zbatueshme

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsye pse?)

Projektligji është finalizuar në shtator 2019 dhe është publikuar për konsultim publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike më datë 16.10.2019, me qëllim marrjen e komenteve/rekomandimeve nga ana e palëve të interesuara.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Për zbatimin e opsionit të preferuar ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), si institucioni përgjegjës për përcjelljen për miratim në Këshillin e Ministrave të propozimeve të paraqitura nga ASHSH, si dhe personat juridikë, publikë ose privatë, që kanë interes publik për realizimin e shpronësimit ose marrjes në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private.

MIE gjithashtu do të monitorojë zbatimin e procedurave të parashikuara në projektligjin e propozuar.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, ka si qëllim rregullimin e së drejtës së shtetit për të shpronësuar ose për të marrë në përdorim të përkohshëm për interes publik, pasuritë e personave fizikë ose juridikë privatë, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të pronarëve përkatës.

Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, është ndryshuar me Ligjin nr. 20/2016, datë 10.3.2016 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Referuar këtij ligji, kur realizimi ose mbrojtja e interesave publike nuk mund të arrihet pa ushtruar të drejtat e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme ose të luajtshme pronë private, Këshilli i Ministrave, mbi kërkesën e subjektit kërkues në favor të të cilit bëhet shpronësimi, me propozim të ministrit kompetent sipas këtij ligji, vendos shpronësimin e këtyre pasurive.

Kur shpronësimi është kryer me kërkesën e një subjekti juridik privat, ministri kompetent, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të pronës shtetërore, është i autorizuar që, mbi kërkesën paraprake të këtij subjekti, të bëjë kalimin e pronësisë së pasurive të shpronësuar nga shteti në favor të subjektit privat që ka kërkuar shpronësimin, me kushtin që të jetë vërtetuar sipas ligjit realizimi i ndërtimit ose investimit për interes publik, për të cilin është kryer shpronësimi.

Gjithashtu, subjekti, në favor të të cilit bëhet shpronësimi, duhet të paraqesë në ministrinë kompetente sipas ligjit, kërkesën për shpronësim, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 10 të ligjit dhe propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës.

Me paraqitjen e kërkesës për shpronësim për interes publik, ministri kompetent urdhëron ngritjen e komisionit të posaçëm për ndjekjen dhe realizimin e procedurave të shpronësimit.

Në përfundim të verifikimeve të nevojshme, si dhe të procedurave të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, kur kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues përkatës janë të mbështetur në kushtet dhe kriteret e këtij ligji, ministria kompetente vendos për pranimin e kërkesës për shpronësim, duke njoftuar menjëherë me shkrim subjektin kërkues në favor të të cilit kërkohet të bëhet shpronësimi.

Ministria kompetente, brenda 10 ditëve nga data e lidhjes së marrëveshjes me subjektin kërkues të shpronësimit, fillon përmbushjen e procedurave të njoftimit të drejtpërdrejtë të secilit pronar a bashkëpronar të pasurive pronë private që kërkohet të shpronësohen ose zhvlerësohen, si dhe personave të tretë lidhur me kompensimin e tyre. Së bashku me procedurat e njoftimit, ministri kompetent realizon edhe ato të publikimit të kërkesës për shpronësim për interes publik.

Ministria kompetente bën publikimin e kërkesës për shpronësim në Fletoren Zyrtare, në një gazetë me shpërndarje në të gjithë vendin dhe në një gazetë vendore për një periudhë një javore.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ligji në fuqi parashikon që kërkesat për shpronësim paraqiten në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës.

Numri i madh i kërkesave për shpronësim, së bashku me problematikat që mund të kenë, kërkojnë komunikim të vazhdueshëm me institucione të tjera dhe kohë të gjatë.

Bashkëpunimi i secilës ministri me këto institucione përbën një cikël të gjatë procedurash, duke shkaktuar vonesa në përmbylljen e tyre.

Grupet e prekura nga ky propozim janë të gjithë personat e interesuar, të cilët mund të jenë juridikë, publikë ose privatë, që kanë interes publik për realizimin e shpronësimit ose marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private.

Duke qenë se të gjitha propozimet për realizimin e shpronësimit ose marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, vijnë si propozime të pakërkuara, rrjedhimisht grupet e prekura nuk mund të kuantifikohen.

Përsa i përket ndikimit që kjo politikë do të ketë në qeveri, sqarojmë se do të përbëjë benefit për qeverinë ulja e numrit të proceseve gjyqësore, me objekt ndryshimin e masës së vlerësimit të shpronësimit.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qeveria planifikon të ndërhyjë për të saktësuar aspektet procedurale në fushën e shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, me qëllim trajtimin e tyre në një kohë sa më të shkurtër dhe me efikasitet.

Ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme me qëllim përqendrimin e kompetencave të shpronësimit në një institucion të vetëm.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje qeveria do të mundësojë:

- ngritjen e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, si një institucion në varësi të ministrit përgjegjës për zhvillimin urban.

- propozimin në Këshillin e Ministrave të miratimit të kërkesave për shpronësim nga ministri përgjegjës për zhvillimin urban.
- shqyrtimin e kërkesave për shpronësim në një kohë më të shkurtër.
- realizimin e procedurave të shpronësimit në mënyrë më eficiente duke i përqendruar në një institucion të vetëm.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesore të këtij propozimi janë:

- Realizimi me efikasitet të procedurave të shpronësimit, duke i përqendruar këto të fundit në një institucion të vetëm, Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.
- Kalimi i kompetencave për procedurat e shpronësimit nga ministrinë kompetente tek Agjencia Shtetërore për Shpronësim.
- Shkurtimi i kohës së shqyrtimit të kërkesave për shpronësim.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Opsioni 0 – Status quo – Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, parashikon që kërkesat për shpronësim paraqiten në ministrinë që mbulon veprimtarinë përkatëse, ndërsa propozimi në Këshillin e Ministrave për miratimin e kërkesës për shpronësim, bëhet nga ministri përkatës.

Bashkëpunimi i secilës ministri me institucione të tjera për plotësimin e me dokumentacionin e duhur të dosjeve të shpronësimit, përbën një cikël të gjatë procedurash dhe që kërkon një kohë të gjatë, duke sjellë kështu vonesa në përmbylljen e tyre. Pra, ky opsion nuk parashikon lehtësira në procedurat e shpronësimit.

Opsioni 1 – Miratimi i një ligji të ri, nëpërmjet së cilit do të realizohet saktësimi i procedurave të shpronësimit, si dhe parashikohet ngritja e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, duke përfshirë një pjesë të madhe të parashikimeve në ligjin në fuqi për shpronësimet..

Opsioni 2 – Ndryshimi i ligjit ekzistues nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, do të sillte të saktësimin e aspekteve procedurale në fushën e shqyrtimit të kërkesave për shpronësim.

Përzgjedhja e opsioneve është mbështetur në vlerësim të karakterit cilësor, pas analizës së të cilit rezultoi se në Opsionin 2 konstatohet një ndikim pozitiv, duke qenë se parashikohet reduktim i kohës së shqyrtimit të kërkesave për shpronësim, si dhe realizim me efikasitet të

procedurave të shpronësimit, nëpërmjet përqendrimit të këtyre të fundit në një institucion të vetëm, Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsioni i preferuar do të prekë drejtpërdrejtë personat juridikë, publikë ose privatë, që kanë interes publik për realizimin e shpronësimit ose marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private.

Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë do të preken të gjitha ministritë të cilat sipas ligjit aktual propozojnë për miratim në Këshillin e Ministrave shpronësimin, sipas fushave përkatëse. Si e tillë, këto procedura nuk do të realizohen më nga këto ministri. Nëpërmjet miratimit të Opsionit 2, propozimet do të përcillen nga ASHSH në ministrinë përgjegjëse për zhvillimin urban dhe kjo e fundit do t'ia dërgojë për miratim Këshillit të Ministrave.

Nga ana tjetër, ndikimi jo i drejtpërdrejtë i këtij opsioni do të jetë nxitja e realizimit të investimeve në fusha të ndryshme nga grupet e prekura të pëmendura më sipër. Duke marrë në konsideratë thjeshtësimin dhe qartësimin e procedurave të shpronësimit, pritet që propozimet për shpronësime të rriten, duke sjellë rritje të investimeve.

Këto ndryshime do të sjellin impakt pozitiv tek personat që do të shpronësohen, së pari referuar procedurave të shpronësimit të cilat me anë të përzgjedhjes së këtij opsioni do të përmirësohen dhe së dyti referuar garantimit të të drejtave të tyre.

Ndryshimet e propozuara me anë të Opsionit 2 nuk kanë ndikim në vlerë monetare. Për këtë arsye nuk vlerësohen kostot dhe përfitimet që mund të sjellin këto ndryshime dhe për rrjedhojë dhe risqet dhe kufizimet.

Përsa i përket familjarizimit të grupeve të prekura me politikën e propozuar, theksojmë se koha për t'u njohur me politikën tashmë konsiderohet e ezauruar, pasi kjo politikë është publikuar nga ana e

Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, si dhe në faqen zyrtare të MIE-s. Në këtë mënyrë të gjitha grupet e interesuara kanë patur mundësinë të njihen me ndryshimet e propozuara dhe të paraqesin komentet e tyre.

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës u kryen duke analizuar numrin e dispozitave dhe neneve që ndryshohen dhe shtohen për të arritur qëllimet/objektivat e kësaj politike. Krahasimi është bërë duke u nisur nga numri total i neneve të projektligjit ekzistues dhe nenet që ndryshohen dhe shtohen.

Në përfundim u arrit në konkluzionin që Opsioni 2 është më i përshtatshëm dhe të jetë në formën e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr .8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar”.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është Opsioni 2, pasi mundëson adresimin e të gjitha problematikave dhe nevojave për ndërhyrje lidhur me aspektet procedurale të shpronësimit.

Opsioni do të sigurojë bazën ligjore të nevojshme për ngritjen e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin, si dhe do të ndërhyrjë në procedurat e shpronësimit me qëllim saktësimin dhe qartësimin e tyre. Ky opsion do të krijojë kushte për kalimin e kompetencave të procedurave të shpronësimit nga ministrinë kompetente tek Agjencia Shtetërore për Shpronësimin.

Zgjedhja e këtij opsioni do të bëjë të mundur gjithashtu përqendrimin në një institucion të vetëm të të gjitha procedurave që lidhen me shpronësimin, duke i bërë ato më eficiente, kjo për arsye se kjo agjenci do të realizojë funksione vetëm përse i përket shpronësimeve. Ndërsa duke qenë e decentralizuar nëpër ministri sjell vonesa dhe konfuzion për faktin se ministrinë kanë shumë kompetenca dhe funksione të tjera.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Për zbatimin e opsionit të përzgjedhur njësia përgjegjëse do të jetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në kuadër të zbatimit të objektivit të politikës do të ndër marrë masat e nevojshme për:

- miratimin e akteve nënligjore që preken nga ky projektligj si më poshtë:
- Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave për ngritjen e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin;
- Ndryshimi i VKM 127, 23.03.2000, “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit të shpronësimit, dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik;

- Ndryshimi i VKM Nr.138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.
- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Monitorimi do të jetë një aktivitet i vazhdueshëm, i cili do të përfshijë mbledhjen e të dhënave

dhe informacionin e kërkuar për matjen e indikatorëve të përcaktuar. Gjithashtu, ai do të jetë një instrument që do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse dhe në të njëjtën kohë do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij ligji.

Ministria përgjegjëse për zhvillimin urban dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin janë përgjegjëse për arritjen e objektivave përkatëse të parashikuara.

Treguesit matës për arritjen e qëllimit të synuar do të jenë:

1. Ulja e numrit të proceseve gjyqësore me objekt ndryshimin e masës së vlerësimit të shpronësimit, si rrjedhojë e bisedimeve bilaterale eficiente ndërmjet ASHSH dhe personave që do të shpronësohen.
2. Ulje e borxhit të akumuluar për shkak të vonesave në pagesa të subjekteve të shpronësuara.
3. Procedura shpronësimi të shkurtuara, sa i përket kohës që nga nisja e kërkesës për shpronësim deri në momentin e likuidimit të personave të shpronësuar.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në										

vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			